

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pas bisedimeve me Putinin, Witkoff dhe Kushner takojnë Zelenskyn: Në tryezë plani për fundin e luftës
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/pas-bisedimeve-me-putinin-witkoff-dhe-kushner-takojne-ze-lenskyn-ne-tryeze-p-i584252
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 09:53:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 10:35:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	96b71245c06e23a615eebca2dffe1732ed6986c54af2d98378c05479491d8cf1
TEKSTI	ba5d92d80ec757f0bf450c8d7c93fcef7b7139f7d4ad1199213e4cd081cb381e8
PAMJA	b7a54de631d34c08a639e8b93e70c27a2ae77ba436bca2d29b798a0cf985cd29

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9611e11f098e7bfd77678abc7fb18796137ee5d95adb4ed3895877343ec80211
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a9a9ddfab3524b675296de199d2c84d7912efeec093d45c9244538a4c87c79b0
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmVa46jty6DHo2iWR4H3GpifXzRT5LfxnJJ5QjG31hJmju



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9611e11f098e7bfd77678abc7fb18796137ee5d95adb4ed3895877343ec80211>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e [Zjarret ne vend/ 735 torca dhe 64 zjarrhese ne terren, angazhohen edhe helikoptere e Air TractorShperthim i fuqishem ne nje kazerme ushtarake ne Bolivi, te pakten 10 fundit](#)

Pas bisedimeve me Putinin, Witkoff dhe Kushner takojnë Zelenskyn: Në tryezë plani për fundin e luftës



6 Shtator 2026, 12:35Bota TEMA



Pas një dite me takime të rëndësishme në Moskë, përfshirë edhe një takim me presidentin Vladimir Putin, të dërguarit amerikanë Steve Witkoff dhe Jared Kushner po ndryshojnë destinacionin e misionit të tyre, duke u nisur drejt Kievit për bisedime me liderin ukrainas Volodymyr Zelensky, me synimin për t'i dhënë fund konfliktit, i cili tashmë ka hyrë në vitin e pestë.

Ajencia shtetërore ruse e lajmeve RIA Novosti raportoi se bisedimet mes të dërguarve amerikanë dhe Putinit zgjatën rreth tri orë, ndërsa përfaqësuesit amerikanë u larguan nga Kremli rreth orës 23:00 më 5 shtator. Pak pas mesnatës, TASS raportoi se amerikanët ishin larguar nga Moska.

Një zyrtar i Shtëpisë së Bardhë i tha Radios Evropa e Lirë se “të dyja palët diskutuan plane konkrete për hapat e ardhshëm, të cilët do të bëhen publikë në javët në vijim” dhe se të dërguarit “presin me padurim takime po aq produktive” në Ukrainë më 6 shtator.

Ndihmësi i Kremlinit, Yury Ushakov, i cili mori pjesë në takim, i cilësoi bisedimet si “substanciale, shumë të sqarta dhe konstruktive”. Ai shtoi se të dërguarit paraqitën qëndrimin e SHBA-së dhe premtuan se do t’ua përcillnin udhëheqësve ukrainas në Kiev pikëpamjet e Putinit.

“Ata jo vetëm që shprehën interesimin e tyre të vazhdueshëm për t’i dhënë fund shpejt luftimeve, por paraqitën edhe një sërë idesh për rrugët e mundshme drejt një zgjidhjeje”, tha ai.

Ushakov këmbënguli se Rusia do t’i arrijë qëllimet e saj dhe se duhet të zgjidhen “shkaqet rrënjësore” të konfliktit. Ky është një formulim që Kremli e përdor për t’u referuar dhënies fund të shpësave të Ukrainës për anëtarësim në NATO dhe hapave për çarmatimin de facto të ushtrisë ukrainase, mes kërkesave të tjera të lidhura me ankesat historike – çështje që Kiev i ka refuzuar që një kohë të gjatë.

Teksa takimi nisi rreth orës 20:00, RIA Novosti e citoi Putinin të ketë thënë se të tre zyrtarët do të duhej të përballeshin me një “situatë të vështirë” gjatë diskutimeve të tyre në Kremlin.

Takimi duket se nisi me vonesë, pasi Putini e kaloi ditën duke hapur një linjë të re të metrosë në Moskë, duke inauguruar përmes video-lidhjes një terminal naftë në Siberi dhe duke u takuar me anëtarë të partisë në pushtet, Rusia e Bashkuar.

Presidenti amerikan, Donald Trump, ka thënë më herët se të dërguarit e Uashingtonit do t'u paraqisnin rusëve një marrëveshje paqeje dhe më pas, të nesërmen, do ta paraqisnin ofertën para Ukrainës.

Trump deklaroi Uashingtoni kishte “një ide për paqen” dhe se të dërguarit e tij “po sillnin me vete një propozim për t'i dhënë fund luftës”, e cila tashmë ka hyrë në vitin e pestë, pasi në shkurt të vitit 2022 Putin nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës.

“I dërgova ata për të parë nëse mund të arrijmë apo jo diçka dhe mund të ketë një shans të mirë që ta bëjmë këtë”, u tha Trump gazetarëve më 4 shtator.

Zelensky tha se kishte folur me të dërguarit më 5 shtator, duke zbuluar pak detaje për bisedën, por duke thënë se “plani i aktiviteteve diplomatike për nesër në Kiev, me pjesëmarrjen e ekipit amerikan, është miratuar”.

“Po presim Steve Witkoff dhe Jared Kushner dhe jemi të gatshëm për një bisedë kuptimplotë”, tha Zelensky në Telegram.

Vizita e të dërguarve amerikanë në Kiev shënon vizitën e tyre të parë në Ukrainë që nga marrja e roleve udhëheqëse në përpjekjet e administratës amerikane për t'i dhënë fund luftës dhe vjen në kuadër të një përpjekjeje të ripërtërirë diplomatike për arritjen e një marrëveshjeje të paqes.

Trump e bëri përfundimin e luftës më të madhe në Evropë që nga viti 1945 një prioritet kur mori detyrën në janar të vitit 2025, por deri më tani nuk është arritur një marrëveshje dhe diplomacia kishte ngecur kryesisht që nga fillimi i luftës SHBA-Izrael me Iranin në fund të shkurtit.

Duke reflektuar qëndrimin e ashpër të paraqitur nga Ushakov, Putini nuk ka dhënë asnjë shenjë kompromisi në deklaratat e fundit, duke këmbëngulur, ndër të tjera, se Rusia duhet të kontrollojë të gjithë rajonin lindor ukrainas të Donjeckut, përfshirë pjesët që forcat e saj nuk kanë arritur t'i pushtojnë gjatë viteve të luftimeve të ashpra.

Para se të niseshin të dërguarit nga SHBA-ja, Zelensky tha se forcat ukrainase do të “sigurojnë funksionimin normal të hapësirës ajrore të Rusisë, në mënyrë që negociatorët të mund të mbërrijnë atje të sigurt” dhe kërkoi që Moska të bënte të njëjtën gjë.

Pas bisedës së tij me të dërguarit më 5 shtator, Zelensky tha se “nga tani deri në fund të së shtunës, si dhe të dielën dhe të hënën, Ukraina është e gatshme të përmbahet nga sulmet ndaj Moskës”.

Më pas, Putini urdhëroi ndalimin e sulmeve ndaj Kievit nga 6 deri më 8 shtator, sipas zëdhënësit Dmitry Peskov, i cili nuk përmendi pjesë të tjera të Ukrainës, mes raportimeve se Rusia ka vazhduar sulmet në pjesë të tjera të Ukrainës.

Zelensky tha se forcat ruse kishin shënjestruar aeroportet Zhuliani dhe Borispil të Kievit gjatë natës së 4-5 shtatorit, duke akuzuar Moskën se po përpiqej të krijonte pasiguri rreth udhëtimit të planifikuar të të dërguarve amerikanë drejt Ukrainës.

Vizita në Kiev do të zhvillohet vetëm disa ditë pasi një sulm me dron nga Rusia goditi selinë e Shërbimit të Sigurisë së Ukrainës – të njohur si SBU, një agjenci kyç që do të ishte përgjegjëse për sigurinë e të dërguarve amerikanë gjatë vizitës së tyre në Ukrainë.

“Është e qartë se këto sulme ruse ndaj aeroporteve janë një reagim ndaj diskutimeve dhe përgatitjeve për mundësinë që pala amerikane të përdorë një aeroplan për të udhëtuar drejt Ukrainës”, tha Zelensky në X, duke shtuar se nga pala ukrainase “nuk do të ketë kërcënime ndaj diplomacisë”.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Shpërthim i fuqishëm në një kazermë ushtarake në Bolivi, të paktën 10 viktima

11:35 Bota

[Sherr për një vajzë! 22-vjeçari shqiptar plagos rëndë me thikë marokenin: Do ju vras](#)

11:25 Bota / 1 koment

[Si u bë Gjermania nga një vend emigrimi në një vend imigrimi](#)

11:15 Bota



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.